



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.03, datë 12.01.2018

PËR

**PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË Z. AFRIM REKA
KUNDËR VENDIMIT NR. 24, DATË 15.12.2017 “PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SUBJEKTIT KOHA JONË NË LIDHJE ME DOMAIN
KOHAJONE .AL ”.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 12.01.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shqyrtimin e ankimit administrativ të z. Afrim Reka kundër Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone.al”.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja k) e nenit 8 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore nr. 02, datë 21.02.2008 për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” (**rregullore**),

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Ankim Administrativ i datës 19.12.2017 (nr. 2380Prot, datë 29.12.2017) i depozituar nga z. Afrim Reka kundër Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017;
2. Projektvendimi për shqyrtimin e ankimit të z. Afrim Reka kundër Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone .al”;
3. Relacioni shoqërues mbi projektvendimin;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Me anë të shkresës depozituar në AKEP me nr. 2309Prot, datë 20.12.2017, z. Afrim Reka ka paraqitur ankim administrativ kundër Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone .al”,
2. Ankimuesi shpjegon se:
 - i. Është njoftuar nga Regjistruesi për vendimmarrjen e AKEP në lidhje me heqjen e pronësisë së domain-it kohajone.al, dhe pretendon si më poshtë vijon:
 - ii. Ankimuesi shprehet se, vendimi është marrë pa e njoftuar dhe pa i kërkuar informacion, duke qenë pronar i këtij domaini prej tre vjetësh. Vendimi është marrë brenda tre ditësh, vendime që zakonisht marrin ~~muaj~~ muaj të tërë.
 - iii. Z. Reka, pretendon se AKEP ka shkelur rregulloren, neni 25, në lidhje me bllokimin e një emri.
 - iv. Ankimuesi shpjegon se, marka tregtare kohajonë është regjistruar më datë 25.1.2016, ndërsa domaini është regjistruar prej 16.12.2013, shumë kohë para markës tregtare. Marka tregtare është e vendosur për industrinë e gazetave, dhe jo në industri të tjera.
 - v. Praktika ndërkombëtare kërkon që çështje të tilla të zgjidhen në bazë të “Domain name dispute resolution” nga WIPO dhe nëpërmjet Vendimit të Gjykatave të Nivelit të Parë. Ankimuesi ka cituar edhe raste të disa çështjeve lidhur me të drejtat e poseduesve të domain-eve.
 - vi. Në përfundim, ankimuesi z. Afrim Reka, kërkon nga AKEP ndryshimin e vendimit Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone .al”.

II. KONSTATIMET DHE ARSYETIMI I AKEP

3. AKEP, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga z.Afrim Reka, posedues i domain kohajone.al, (pas verifikimeve në sistem lidhur me aplikimin për regjistrim domain), konstaton se, ankesa është paraqitur brenda afateve dhe plotëson kushtet e pranimit të parashikuara sipas neneve 131 e 135 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave i Republikës së shqipërisë”.
4. Lidhur me sa kërkohet nga ankimuesi për ndryshimin e Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone.al”, vërehet se:

- i. Vendimi nr. 24, i datës 15.12.2017, “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone.al”, në pjesën arsyetuese të tij, ka shpjeguar konstatimet dhe argumentet të cilat kanë çuar në këtë vendimmarrje, duke e gjetur atë në përputhje me nenin 25, pika 25.1 të rregullores. Ankimuesi, z. Afrim Reka, poseduesi i domain-it kohajone.al, është gjetur në shkelje të pikës 11.2 të nenit 11, të Rregullores nr. 02/2008.
- ii. Për sa i takon pretendimit të ankimuesit për heqjen e pronësisë së domain-it kohajone.al, sqarojmë se:
 - Termi “Pronësi” apo “heqje pronësie” nuk është përdorur në asnjë nga dispozitat e rregullores nr. 02/2008.
 - në pikën nr. 1, të Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017, bazuar në nenin 25, të Rregullores nr. 02/2008, AKEP ka vendosur: *Bllokimin e emrit të domain kohajone.al*. AKEP nuk ka marrë vendim për heqje pronësie të domain-it.
 - Bazuar në nenin 1, pika 1.4, të rregullores, “*bllokim*” – është veprimi i cili përfshin mbylljen (tërheqjen) dhe ç’aktivizimin e përkohshëm të emrit të domainit nga shërbimi DNS, duke e bërë atë jo të përdorshëm deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi kompetent. Në këtë gjendje (status) emri i domain-it vazhdon t’i përkasë poseduesit të tij dhe si rrjedhim, emri i domain-i, të bllokuar nuk mund të regjistrohet nga ndonjë palë tjetër.

Sa më lart shpjeguar, pretendimi për heqje të pronësisë me anë të Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017, të cilin ju ankimoni, nuk qëndron, është i pabazuar.

- vii. Sa i takon pretendimit për dalje jashtë parashikimeve të rregullores për pjesën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (Domain Name Dispute Resolution Name), sqarojmë se AKEP në cilësinë e organit administrativ, trajton ankimet administrative në kuadër të ezaurimit të procedurës ankimuese administrative fillimisht, e më pas vijimin e ankimit në rrugë gjyqësore nga palët e interesuara sipas parashikimeve në K.Pr.A.
- viii. Në përfundim të argumenteve dhe shpjegimeve si më lart, AKEP arrin në konkluzionin se, ankimi i paraqitur nga z. Afrim Reka kundër Vendimit nr. 24, datë 15.12.2017, është i pabazuar ligjërisht.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të shkronjës k) të nenit 8, pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S:

1. Të refuzojë ankimin e paraqitur nga z. Afrim Reka me shkresën nr. 2380Prot, datë 29.12.2017, kundër Vendimit të Këshillit Drejtues “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Koha Jonë në lidhje me domain kohajone.al”, si të pabazuar ligjërisht.

2. Të njoftohet z. Afrim Reka për këtë Vendim.
3. Palët kanë të drejtën e ankimit të këtij Vendimi në rrugë gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**